

ARMEND MEHMETI

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë

armend.mehmeti@gmail.com

**MIDIS DËBIMIT DHE ASIMILIMIT
PËRPPJEKJET PËR SHPËRNGULJEN E SHQIPTARËVE
NGA KOSOVA. KONVENTA TURKO-JUGOSLLAVE
E VITIT 1938**

Abstrakt:

Ngritja dhe forcimi i shtetit serb në gjysmën e parë të shek. XIX u shoqërua me zbatimin e projekteve dhe të politikave ekspansioniste, të cilat do të marrin një dimension më të theksuar gjatë gjysmës së parë të shek. XX. Projektet për një shtet të pastër etnik serb dhe dalje në Egje apo Adriatik u shoqëruan me pushtimin e trevave të banuara me shqiptarë dhe ndjekjen e një politike dëbimi apo shkombëtarizimi karshi vendësve. Në ndjekjen e këtij qëllimi qarqet politike dhe akademike serbe sajuan argumente të ndryshme, duke u thirrur në “të drejtën historike” të shtetit mesjetar serb. Shpërnguljet dhe politika serbe e spastrimit etnik të viseve shqiptare është një temë që gjerësisht është trajtuar nga historiografia shqiptare, por esenca e njëkohësisht risia e këtij punimi qëndron në faktin se shtjellimi dhe analizimi i këtij problemi bëhet me qasje ndërdisiplinore, në katër dimensione komplementare të njëra-tjetrës: përpjekjet e pushtetit serb për shpërnguljen e shqiptarëve në masë, diskursi publik në Serbi, politikat turke të emigracionit dhe përpjekjet e shtetit shqiptar për të penguar shpërnguljen në masë. Punimi është hartuar sipas parimit kronologjik përmes metodave analizuuese, dhe bazohet në materiale arkivore e literaturë nga provenienca shqiptare, jugosllave dhe turke.

Fjalë kyçe:

Shpërngulje, kolonizim, asimilim, shqiptarë, myslimanë, Jugosllavia, Mustafa Qemal Atatürk etj.

Hyrje

Ngritja dhe forcimi i shtetit serb në gjysmën e parë të shek. XIX u shoqërua me zbatimin e projekteve dhe të politikave hegjemoniste dhe ekspansioniste. Në përpjekje për të zbatuar të “drejtën historike” të

Serbisë dhe të restaurimit të shtetit mesjetar serb të Stefan Dushanit, ngritja e të cilit qe ndërprerë nga Beteja e Kosovës më 1389,¹ Ilija Garashanin, atëherë ministër i Brendshëm i Serbisë, hartoi në vitin 1844 platformën e titulluar “Naçertanije”. Platforma argumentonte nevojën për pozicionimin e Serbisë për të plotësuar, sikur parashikonte ai, vakuumin që do të krijohet nga rënia e Perandorisë Austro-Hungareze dhe asaj Osmane. Në rrethanat që do të krijoheshin, platforma bënte thirrje për aneksimin e trojeve që konsideroheshin “serbe dhe ortodokse”, përfshi këtu: Bosnjën, Hercegovinën, Malin e Zi, Vojvodinën, Kosovën dhe Shqipërinë e Veriut”,² për të krijuar kështu një shtet të zgjeruar serb.

Por, dështimi i lëvizjeve të popujve të ndryshëm për t’u çliruar nga sundimi austro-hungarez bëri që Grashanini të kuptonte se Austro-Hungaria ishte një shtet i fuqishëm për Serbinë e vogël, prandaj projektin “Naçertanije” e orientoi kundër Perandorisë Osmane.³ Rrjedhimisht, në kushtet kur Serbia nuk mund të zgjerohej në Lindje, zgjerimi u orientua në drejtim të Jugut. Është pikërisht kjo periudha kur kjo e fundit filloi politikën ekspansioniste në drejtim të tokave shqiptare, që do të shoqërohej me një politikë të spastrimit etnik.* Kështu, gjatë luftës midis Ruisë dhe Perandorisë Osmane (1877-1878), në të cilën Serbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Rumania ishte aleatë të së parës, qarqet ushtarake dhe politike serbe larguan me dhunë rreth 200 000 shqiptarë të Sanxhakut të Nishit.⁴

Zgjerimi territorial në drejtim të Jugut nuk i kishte plotësuar pretendimet hegjemoniste serbe. Prandaj, shtypja e Lidhjes Shqiptare të

¹ Hakif Bajrami, “Ilija Garashanin dhe politika e tij shtetërore 1844-1874”, *Vjetari-Godišnjak*, nr. XXIV (1988), 129.

² Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit, Shekulli tetëmbëdhjetë-nëntëmbëdhjetë* (Tiranë: Përpjekja, 1999), 231-232; *Enciklopedija Jugoslavije* (Zagreb: Izd. i Naklada Leksikografskog Zavoda, 1958), 429.

³ George Castellan, *Histori e Ballkanit* (Tiranë: Çabej, 1997), 326.

* Sipas një përkufizimi të Kombeve të Bashkuara, “Spastrimi etnik” nënkupton veprimet për të krijuar zona gjeografike etnikisht homogjene nëpërmjet dëbimit ose zhvendosjes me forcë të personave që u përkasin grupeve të veçanta etnike... Për më tepër, shih: *Ethnic cleansing* (shikuar më 05.07.2023):

<https://www.un.org/en/genocideprevention/ethnic-cleansing.shtml>.

⁴ Sabit Uka, “Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX,” në *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, Sadri Fetiu (red.), et. al. (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1996), 162.

Prizrenit rriti interesimin e qeverisë serbe për trevat shqiptare.⁵ Jovan Cvijiq, njëri ndër ideologët kryesorë të zgjerimit të shtetit serb, pohonte se, Kongresi i Berlinit i vitit 1878 e kishte lënë Serbinë një “vend të rrethuar”, prandaj ajo duhej të dilte në det. Nën drejtimin e Cvijiqit, qeveria serbe kishte përgatitur një studim të detajuar mbi “territorin e Serbisë së Vjetër”.⁶ Emërtimi “Serbi e Vjetër” si një term gjeografik që lindi në shek. XIX nënkuptonte një hapësirë prej 40 000 km² të territoreve të sotme të Maqedonisë Veriore, Kosovës dhe të Sanxhakut, që pretendoheshin si ish-treva të Serbisë mesjetare.⁷

Në idetë e politikanit serb, Ristiç, rëndësi të veçantë kishte sidomos pozita gjeografike e Kosovës, e cila, duke u shtrirë në pjesën qendrore të Ballkanit, siguronte daljen më të shpejtë në Adriatik e në Egje.⁸ Prandaj, Serbia ishte iniciatore e krijimit të një aleance ballkanike të shteteve të krishtera ortodokse, që u arrit nga fundi i vitit 1912, të cilat pretendimet e tyre territoriale kundër Perandorisë Osmane, me këtë edhe të trevave të shqiptarëve, i mbështetën në kritere të ndryshme kulturore, historike dhe gjuhësore.⁹ Si rezultat, Luftërat Ballkanike (1912-1913) jo vetëm që larguan Perandorinë Osmane nga Ballkani, por edhe shpërngulën në masë një popullsi të madhe të besimit mysliman.* Vendimet e Konferencës së

⁵ Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës* (Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste të Kosovës, 1969), 75.

⁶ Михаило Војводић, *Srbija u Albansko pitanje krajem XIX Veka*, vol. Књига 15 (Београд: Српска Академија Наука и Уметности, Одељење Историјских Наука, 1990), 94-95. (Mihailo Vojvodić, *Srbija i Albansko Nimanje krajem XIX Veka*, vol. Knjiga 15 (Beograd: Srpska Akademija Nauka i Ymetnosti, Odelejene Istorijskih Nauka).

⁷ Јевто Дедијер, “Стара Србија географска и етнографска слика (1912.)”, Београд, 2000 (Jevto Dedijer, “Stara Srbija geografska i etnografska slika (1912)”, Beograd, 2000) (shikuar më 10.04.2023), <https://dokumen.tips/download/link/dr-jevto-dedijer-stara-srbija-geografska-i-etnografska-slika.html>

⁸ Ali Hadri, “Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1919-1941),” në *E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Kristaq Prifti (red.), (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1990), 234.

⁹ Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913: Prelude to the First World War* (London, New York: Routledge, 2000), 4-5.

* Në vitin 1911 në zonat osmane që u pushtuan nga Greqia, Serbia dhe Bullgaria jetonin rreth 2 315 293 banorë të besimit islam, kurse pas Luftërave Ballkanike në territoret e njëjta mbetën 870 114 banorë të besimit të njëjtë, pra rreth 1 445 179 banorë të besimit islam u shpërngulën nga trojet e tyre. Në këtë numër përfshihen edhe shqiptarët, pasi regjistrimet e popullsisë në Perandorinë Osmane ishin kryer në baza

Ambasadorëve në Londër (1913) lanë gjysmën e popullsisë dhe të trevave shqiptare jashtë Shqipërisë së pavarur. Vetëm nën Serbi e Mal të Zi mbetën të paktën 900 000 shqiptarë, në një territor prej 22 000 km².¹⁰ Shqiptarët që mbetën nën regjimin serb e malazez iu nënshtuan dhunës fizike dhe presionit psikologjik, shkatërrimit të vendbanimeve dhe grabitjes së ushqimeve e të bagëtisë.¹¹ Krahas vrasjeve, pushteti serbo-malazez zbatoi edhe konvertimin e dhunshëm të banorëve shqiptarë të besimit katolik dhe mysliman në ortodoksi sllave.¹² Qëllimi i konvertimit ishte shkombëtarizimi dhe asimilimi i asaj pjese të popullsisë që do ta pranonte ndërrimin e fesë, dhe shpërnguljen e asaj pjese që nuk do ta pranonte këtë. Në këtë mënyrë ishte menduar spastrimi etnik dhe krijimi i një Kosove të pastër sllave e ortodokse.¹³ Si shkak i dhunës së pushtetit serb gjatë viteve 1913-1915 ndaj shqiptarëve të Kosovës për në Anadolli dhe pjesërisht për në Shqipëri u shpërngulën rreth 120 000 shqiptarë.¹⁴

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Kosova dhe trevat e tjera veriore e verilindore shqiptare mbetën nën Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene. Rifilloi represioni dhe politika antishqiptare që ishte ndërprerë me largimin e ushtrisë serbe nga Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore.* Qëllimi i kësaj politike konsistonte në integrimin e tërësishëm të trevave të banuara me shqiptarë në shtetin serbo-kroato-sllloven, një

teokratike. Për më tepër, shih: Justin McCarthy, *Vdekje dhe dëbim – Spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922* (Tiranë: Alsar, 2017), 171.

¹⁰ Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1992), 9.

¹¹ McCarthy, *Vdekje dhe dëbim*, 155; Zekeria Cana, *Shpalime historike*, vol. II (Prishtinë: Libri Shkollor, 1988), 165.

¹² Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)* (Prishtinë: Rentabil-Kosova, 2001), 29.

¹³ *Po aty*, 29.

¹⁴ Hakif Bajrami, “Konventa jugosllave-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve”, në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Hakif Bajrami (red.) (Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992), 177.

* Gjatë tetorit të vitit 1918, avionët serbë kishin hedhur proklamata paralajmëruese në pjesë të ndryshme të Kosovës. Këto proklamata, me tone kërcënuese e të shkuara në gjuhën turke, përveçse njoftonin popullin shqiptar për depërtimin e ushtrisë serbe në Kosovë, kërkonin që shqiptarët të qëndronin të qetë duke i paralajmëruar ata për “krimet e vjeshtës së vitit 1915, dhe se nga qëndrimi i tyre do të varej edhe fati i tyre i mëtejshëm”. Për më tepër, shih: Bogumil Hrabak, “Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države s arbanasikom većinom stanovništva u jesen 1918. godine i držanje arbanasa prema uspostavljenju vlasti”, *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1 (1969): 255-257.

qëllim që mund të arrihej vetëm përmes ndryshimit të strukturës etnike të Kosovës, respektivisht në uljen e numrit të shqiptarëve dhe shtimit të elementit sllav.¹⁵

Masat e para në realizimin e një qëllimi të tillë përfshinin aksionet për çarmatimin e vendësve shqiptarë, që u përdorën edhe si një mekanizëm për zbatimin e dhunës sistematike me qëllim për t'i detyruar që të shpërnguleshin. Në vitet e para pas përfundimit të luftës, ato organizoheshin mbi baza vjetore dhe shoqëroheshin me vrasje masive, djegie e shkatërrime të vendbanimeve etj. Ndër aksionet më të përgjakura të çarmatimit ishte ai i dimrit 1920-1921, që filloi në rajonin e Llapit dhe të Gallapit, e që vazhdoi më pas edhe në rajonet e tjera.¹⁶ Sipas të dhënave të cilat Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës,* ia kishte adresuar Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, gjatë viteve 1918-1921 pushteti serbo-kroato-slloven kishte kryer në Kosovë këto mizori: të vrarë gjithsej – 12 346 njerëz, të burgosur – 23 060, të rrahur – 1 635, shtëpi të djegura – 6 025 dhe shtëpi të plaçkitura – 10 515.¹⁷

Krahas dhunës sistematike gjatë vitit 1919 filloi edhe vendosja e kolonëve sllavë në Kosovë, për të cilët ishte krijuar edhe infrastruktura e nevojshme ligjore.¹⁸ Rregullorja për zbatimin e reformës agrare, e datës 27 shkurt 1919 dhe Rregullorja për kolonizimin e viseve jugore, e datës 24 shtator 1920, të cilat u shndërruan në ligje më vonë, kishin për qëllim sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për kolonët sllavë, duke ngushtuar njëkohësisht hapësirën jetësore të shqiptarëve.¹⁹ Në arritjen e këtij

¹⁵ Sabri Rexha, *Raportet shqiptaro-serbe në Kosovë* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011), 160.

¹⁶ Zamir Shtylla, “Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve në vitet 1912-1941,” në *E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, 262-63.

* Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (1918-1924) ishte një organizatë politike-ushtarake që kishte për qëllim rimëkëmbjen e shtetit shqiptar, çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Për më tepër, shih: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2007), 125.

¹⁷ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, Fondi (më tej: F.) Komiteti i Kosovës, Viti (më tej: V.) 1922, Dosja (më tej: D.) 31/21; Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb (1844-1995)*, (Prishtinë: QIK, 1995), 96; Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927* (Tiranë: Shtëpia Botuese “Enciklopedike”, 1992), 133.

¹⁸ Ђорђо Крстић, *Колонизација Јужне Србије* (Сарајево: 1928), (Gjorgjo Krstiq, *Kolonizacija Juzhne Srbije*, Sarajevo: 1928), 6.

¹⁹ Rexha, *Raportet shqiptaro-serbe në Kosovë*, 166.

objektivi deri më 1 janar 1928, qeveria serbo-kroato-slllovene kishte ndarë rreth 225 397 hektarë tokë për kolonët dhe për ngritjen e vendbanimeve të tyre.²⁰ Deri në vitin 1928 në Kosovë u ngrit një numër kolonish sllave. Sipas dispozitave për kolonizim mund të shfrytëzoheshin: tokat shtetërore, tokat e fshatarëve, tokat e braktisura, pasuritë e të arratisurve dhe çdo lloj prone në kuadër të dispozitave përkatëse.²¹

Konfiskimi i tokave dhe pamundësia e mbijetesës ekonomike, për shkak se bujqësia ishte e vetmja degë ekonomike në Kosovë, por edhe shtypja e rezistencës kaçake,²² u shoqërua me largimin e një pjese të konsiderueshme të popullsisë në drejtim të Shqipërisë apo Turqisë. Sipas burimeve diplomatike jugosllave, në korrik të vitit 1925 rreth 750 familje shqiptare myslimane nga Kosova, Maqedonia dhe Sanxhaku qëndronin në Selanik në pritje për të kaluar në Turqi.²³ Për të mundësuar largimin e tyre pushteti serbo-kroato-sllloven kishte krijuar lehtësira të shumta: dhënia formale e pasaportave për shpërngulje, lirimin e meshkujve nga shërbimi ushtarak, lirimin nga detyrimet e ndryshme administrative-financiare etj. Njëkohësisht, qeveria jugosllave punonte për të pamundësuar rikthimin e atyre që ishin shpërngulur, përmes mosdhënies së vizave apo duke krijuar probleme të natyrës administrative e teknike.²⁴

Pozita e rëndë e popullsisë shqiptare në Kosovë dokumentohet përmes memorandumit të titulluar “*Gjendja e pakicës shqiptare në Jugosllavi*”, të parashtruar në Lidhjen e Kombeve më 5 maj 1930 nga priftërinjtë katolikë shqiptarë, si: dom Gjon Bisaku, dom Shtjefën Kurti dhe dom Luigj Gashi.²⁵ Në këtë dokument, represioni shtetëror ndaj shqiptarëve pasqyrohet në tri dimensione kryesore: a) persekutimit të të gjitha llojeve, për ta bërë të detyrueshëm largimin; b) përdorimi i dhunës për shkombëtarizimin e detyruar të popullsisë; dhe c) syrgjynosje dhe shfarosje të elementëve që nuk pranojnë as të lënë vendin e as t’i

²⁰ Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 1981), 66.

²¹ Milan Obradović, *Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005), 169.

²² Liman Rushiti, *Kujtime për Lëvizjen Kaçake* (Prishtinë: 2003), 5-6.

²³ Qerim Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë 1922-1941 (Përmbledhje dokumentesh)* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019), 90-91.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ Hivzi Islami, *Spastrimet etnike – politika gjenocidiale serbe ndaj shqiptarëve (Shqyrtime, komente, elaborate, dokumente)* (Pejë: Dukagjini, 2003), 190.

nënshtrohen serbizimit.²⁶ Më tej, nëpërmjet shtojcave të veçanta dokumenti ofron detaje të specifikuar mbi shpërnguljen e detyruar, kufizimin e lirisë individuale, mohimin e të drejtave qytetare dhe pronësore, konfiskimet e pronave tokësore, mohimin e shkollimit dhe të përdorimit të gjuhës amtare etj.,²⁷ pavarësisht se shqiptarët përbënin rreth 70% të popullsisë në Kosovë,²⁸ dhe pavarësisht asaj se Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene kishte nënshkruar në shtator të vitit 1919 Traktatin e Sen-Zhermenit për mbrojtjen e pakicave.²⁹

Si rezultat i mohimit të të drejtave elementare njerëzore dhe etnike, një numër i madh i shqiptarëve shpëtimin e shihnin në largimin nga Kosova, kurse Shqipëria dhe Turqia shiheshin si vende ku mund të emigronin për shkak të gjuhës apo religjionit. Kështu, në periudhën midis Dy Luftërave Botërore u larguan një numër prej 90 000 deri 150 000 shqiptarësh. Në anën tjetër, si rezultat i realizimit të reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë u vendosën rreth 53 000 banorë sllavë.³⁰

Përpjekjet për shpërngulje në masë

Presioni shtetëror filloi të marrë një dimension të ri nga mesi i viteve 1930 kur qarqet politike jugosllave, të vetëdijshme se reforma agrare dhe kolonizimi nuk kishin dhënë rezultatet e pritura, filluan me hartimin e projekteve të reja për shkombëtarizimin e viseve të banuara me shqiptarë, përmes një dëbimi të organizuar e masiv. Nismat për dëbimin e organizuar të shqiptarëve filluan në vitin 1930 kur përpjekjet për formimin e një blloku të shteteve ballkanike për t'i rezistuar presionit të Fuqive të Mëdha dhe për të përballuar më lehtë depresionin ekonomik

²⁶ *Gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi, Promemorie e paraqitur në Lidhjen e Kombeve (1930) nga dom Gj. Bisaku, dom Sh. Kurti, dom L. Gashi*, red. Briseida Mema, Marenglen Verli (Tiranë: Koha, 1995), 25.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ Sipas të dhënave në dispozicion del se në Kosovë më 1921 kishte 461 970 banorë, më 1931 552 352 banorë e në mars të vitit 1941 kishte 660 276 banorë. Për më tepër, shih: Ali Hadri, "Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)", *Gjurmime Albanologjike*, nr. 2 (1968): 164.

²⁹ *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (më tej: *ASHAK*), F. Arkivi Diplomatik i MPJ-së në Beograd, D. Lidhja e Kombeve, 1-4.

³⁰ Oliver Jens Schmitt, *Kosova – Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike* (Prishtinë: Koha, 2012), 158; Obradoviq, *Reforma agrare*, 261.

që kishte shpërthyer më 1929,³¹ çuan në përmirësimin e raporteve turko-jugosllave.* Qeveria jugosllave i shihte me simpati përpjekjet dhe interesimin e Ankarasë zyrtare për popullimin e hapësirave të gjera të Anadollit me popullsi myslimane që jetonin në shtetet ballkanike si Rumani, Bullgari etj., proces që e shihte si një mundësi për dëbimin e shqiptarëve. Një ide e tillë u shtjellua fillimisht më 1930 midis përfaqësuesve diplomatikë turq e jugosllavë, për të arritur një marrëveshje në parim për shpërnguljen e popullsisë turke dhe myslimane prej Jugosllavisë. Në shtator të vitit 1931, diplomati turk, Ruzhdi Aras, i deklaroi diplomatit jugosllav në Lidhjen e Kombeve se Turqia do të ishte e gatshme të pranonte rreth 200 000 njerëz të “popullsisë që ka mentalitet të njëjtë me popullsinë turke, prandaj në Turqi do të asimilohet lehtë, siç është rasti me disa pjesë të popullsisë shqiptare tek ne”.³² Mundësia për t’i dëbuar shqiptarët u diskutua si temë shtesë gjatë një takimi midis ministrave të Jashtëm të Jugosllavisë dhe të Turqisë në Beograd, më 28 shkurt 1933, me temë qendrore nënshkrimi i një pakti të miqësisë midis Turqisë dhe Jugosllavisë.³³

Konsultimet intensive për një projekt të tillë filluan me ardhjen e Milan Stojadinoviçit në krye të qeverisë jugosllave, në qershor të vitit 1935. Ardhja e tij në pushtet shënoi periudhën kur bashkë me Mbretin Aleksandër mori fund edhe ideja e jugosllavizimit*, ndërsa si një anëtar i Partisë Radikale ai u kushtoi më tepër vëmendje ideve nacionaliste serbe. Qysh në ditët e para të qeverisjes së tij ishte vërejtur orientimi i tij nga shtetet fashiste. Sipas ministrit të Jashtëm italian, Galeazzo Ciano, “Stojadinoviç është fashist. Nëse jo hapur, atëherë gjithsesi në relacion të konceptit mbi autoritetin dhe partinë”.³⁴ Në korrik, nën drejtimin e tij u formua një komision ndërqeveritar në kuadër të MPJ-së jugosllave, i cili u ngarkua me përgatitjen e një projekti për shpërnguljen e shqiptarëve

³¹ L.S. Stavrianos, *Balkans since 1453* (London: Hurst & Company, 2000), 736.

* Në vitin 1929, Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene u emërtua Mbretëria e Jugosllavisë.

³² Hadri, “Pozita dhe gjendja e Kosovës”, 179.

³³ Bajrami, “Konventa jugosllave-turke e vitit 1938”, 176.

* Në një periudhë të shkurtër kohore, para se të vritej në Marsejë (shtator 1934), te Mbreti Aleksandër kishte filluar të mbizotëronte bindja se projekti i jugosllavizimit, të cilin ai e promovonte me zell, po shkonte drejt dështimit. Për më tepër, shih: *Споменица Лjubомира Давидовића* (Beograd: 1940) (*Spomenica Ljubomira Davidoviça*, Beograd: 1940), 22.

³⁴ Ferdo Čulinoviç, *Jugoslavija između dva rata*, Knjiga II (Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umijetnosti, 1961), 114.

për në Turqi. Ky komision përbëhej nga përfaqësues të Ministrive të Punëve të Jashtme, të Bujqësisë, të Financave, të Komunikacionit dhe të Ushtrisë e Marinës. Komisioni në fjalë mbajti disa takime, ku u diskutuan modalitetet për mënyrat e realizimit të shpërnguljes në masë të popullsisë shqiptare nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, pasi u vlerësua se kolonizimi nuk i kishte arritur efektet e duhura ndërsa popullsia shqiptare nga viti 1931 deri më 1935 ishte shtuar me 66 000 banorë.³⁵ Për të detyruar largimin e popullsisë shqiptare në drejtim të Turqisë u propozuan një varg masash: detyrimi për pagimin e të gjitha taksave; largimin e emigrantëve nga Shqipëria që jetonin në Jugosllavi; detyrimin që fëmijët shqiptarë të vijonin mësimet në shkollat serbe; largimi nga shërbimi administrativ i atyre që nuk pranonin të shpërnguleshin; të krijoheshin një zonë me popullsi sllave përgjatë kufirit me Shqipërinë; të vazhdonte kolonizimi etj.³⁶ Nga ky diskutim dolën disa konkluzione, të cilat u miratuan në takimet e radhës që pati ky komision: 1) me qeverinë turke të iniciohej çështja e shpërnguljes, dhe ajo të bëhej përmes një konvente sikurse me Rumaninë; 2) t'u jepeshin pasaporta udhëtimi atyre që donin të shpërnguleshin; 3) të liroheshin nga taksat ata që donin të shpërnguleshin; 4) të liroheshin nga detyrimi ushtarak ata që donin të shpërnguleshin; dhe 5) të varfërve t'u sigurohej transporti falas, kurse të tjerëve që kishin shitur pronën me 75% lirim.³⁷

Gjatë mbledhjeve të këtij komisioni u diskutua edhe çështja e refuzimit të largimit të shqiptarëve nga trevat e tyre. Në mbledhjen e 24 shtatorit të vitit 1935, u arrit në konkluzionin se, nëse shtetasit shqiptarë të Jugosllavisë nuk do të pranonin të largoheshin nga zonat kufitare me Shqipërinë, atëherë duhej të përdroreshin dispozitat ligjore që mundësonin shpërnguljen e tyre në brendësi të Jugosllavisë ku do të asimiloheshin nga popullsia mbizotëruese sllave,³⁸ ndërsa vendbanimet e tyre do të populloheshin nga popullsia sllave. Sikurse shihet, prioritet iu dha sidomos shpërnguljes së popullatës shqiptare nga zonat kufitare me Shqipërinë. Për t'i realizuar konkluzionet e mësipërme autoritetet jugosllave filluan me konfiskimin e pronave të paluajtshme. Toka u shpall pronë shtetërore dhe u ndalua regjistrimi në regjistrat pronësorë si

³⁵ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 169.

³⁶ *Po aty*, 172.

³⁷ *Po aty*, 173.

³⁸ Bajrami, "Konventa jugosllave-turke", 179.

tokë private. Toka që u merrej shqiptarëve, u jepej kolonëve.³⁹ Këto masa paraqisnin krijimin e parakushteve për shpërnguljen e shqiptarëve, fillimisht duke ndërprerë komunikimin e tyre me bashkëkombësit apo shtetin amë.

Konkluzioneve nga konferenca e mësipërme u kishte paraprirë një analizë e konsullit të konsullatës së përgjithshme jugosllave në Stamboll rreth mundësisë për arritjen e një marrëveshjeje për shpërnguljen e popullsisë “myslimane” në Turqi, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, më 3 maj 1935. Pas një ekspozije rreth largimit të popullsisë josllave nga territori i Serbisë Jugore, si një ndër çështjet më të rëndësishme nacionale-politike, ai vinte në pah se qeveria turke i kishte vënë vetes detyrë që elementin e huaj ta largonte nga territori i saj dhe ta zëvendësonte atë me elementin turk apo mysliman nga vendet ballkanike. Territore të Turqisë ishin populluar me myslimanë nga Rumania dhe Bullgaria, prandaj në këto rrethana konsulli vlerësonte se ishte paraqitur momenti i volitshëm për të negociuar me qeverinë turke shpërnguljen në masë të “myslimanëve” sipas një plani të caktuar dhe me ndihmën financiare jugosllave. Sipas mendimit të konsullit, “*secilit mysliman që dëshiron të lëshojë Serbinë Jugore duhej t’i mundësohej shitja e pasurisë, kurse për shpërngulje do të përdorej linja detare Selanik-Stamboll apo hekurudha Selanik-Edrene*”.⁴⁰ Analiza në fjalë kishte të bënte me qëllimet për largimin e elementit shqiptar nga Kosova dhe viset e tjera në Jugosllavi. Kjo dëshmohet në njërin prej paragrafëve të analizës së sipërpërmendur, ku përcaktohet qartë se largimi për në Shqipëri do ta rriste popullsinë shqiptare dhe do ta forconte lëvizjen irredentiste, ndërsa shpërngulja për në Turqi do ta bënte të humbur përfundimisht këtë element dhe do të krijonte zgjidhje me fat për shtetin jugosllav.⁴¹

Diskursi publik - Klubi kulturor serb dhe elaborati i akademikut Vasa Çubriloviq

Konkluzionet e qeverisë jugosllave për dëbimin e shqiptarëve u mbështetën nga elita akademike e kulturore serbe, e cila gjatë periudhës në fjalë ishte përqendruar rreth Klubit kulturor serb. Klubi kulturor serb

³⁹ Branko Horvat, *Kosovsko pitanje* (Zagreb: Globus, 1988), 67.

⁴⁰ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 146-147.

⁴¹ *Po aty*.

ishite një organizatë që punoi për ngritjen e vetëdijes letrare e kulturore serbe mbi baza historike kombëtare, dhe veproi gjatë viteve 1937-1941. Pjesën më të madhe të anëtarësisë e përbënin kuadrot universitarë, akademikë e kulturorë, por kishte anëtarë edhe nga elita politike, tregtare, financiare dhe industriale, madje edhe asaj ushtarake. Në krye të këtij klubi qëndronte Slobodan Jovanović, njëri nga diplomatët dhe intelektualët më të njohur të periudhës në fjalë, kurse Vasa Çubriloviq ishte sekretar.⁴² Ideologjia e këtij klubi mori tiparet themelore të nacionalizmit etnik, kulturor, politik dhe klasor serb kundrejt popujve apo grupeve të tjera etnike në Jugosllavi. Mbi të gjitha këto dominonte parimi etnik, sepse flitej e shkruhej për etnosin e pastër serb, sidomos në territoret me popullsi të përzier. Një ndër sloganet më të famshme të klubit kulturor serb ishte: “*Aty ku ka serbë, aty është Serbi*”.⁴³

Klubi kulturor serb zhvilloi një aktivitet të dendur propagandistik përmes prezantimeve që kryesisht u mbajtën në Beograd. Në këto prezantime u trajtuan tema të karakterit kombëtar serb, të çështjeve arsimore, kulturore dhe ekonomike. Një kujdes i veçantë i kushtua rajoneve ku serbët nuk përbënin shumicën, respektivisht “Serbisë Jugore”, apo Kosovës dhe Maqedonisë së sotme. Klubi kulturor serb ndoqi me vëmendje procesin e kolonizimit me serbë të këtyre viseve.⁴⁴ Theksi vihej te mbizotërimi i elementit serb mbi popullsinë vendore. Fokusi u drejtua sidomos ndaj shqiptarëve. Pasi nuk mund të mohohej ekzistenca kombëtare e shqiptarëve, sikurse iu mohua maqedonasve, atyre iu mohua e drejta e territorit ku banonin. Në radhë të parë u shpreh pakënaqësia lidhur me rezultatet e kolonizimit, që u zhvillua gjatë viteve 1921-1936. U vlerësua se gjendja numerike e popullsisë serbe në Kosovë

⁴² "Српски културни клуб изабрао је синоћ своју управу", *Политика*, Београд, 5.2.1937, 9 ("Srpski kulturni klub izabrao je sinoć svoju upravu", *Politika*, Beograd, 5.2.1937).

⁴³ Nebojša A. Popović, "Srpski kulturni klub (1937-1941)", *Istorija 20. Veka*, nr. 1-2 (1989), 112-121.

⁴⁴ Љубодраг Димић, "Слободан Јовановић и Српски културни клуб (1937-1941)," në *Слободан Јовановић, поводом 150 година од рођења*, ред. Марко Анђелковић (Београд: Српска Академија Наука и Уметности, 2020), (Ljubodrag Dimić, "Slobodan Jovanović i Srpski kulturni klub (1937-1941)", në *Slobodan Jovanović Novodom 150 godina od pozhena*, Marko Anzheliković (red.) (Beograd: Srpska Akademija Nauka i Ymetnosti, 2020), 194.

kishte mbetur e njëjtë, kurse shqiptarët ishin futur si një pykë që ndërpriste lidhjen midis Serbisë Veriore dhe asaj Jugore.⁴⁵

Në kuadër të këtij klubi organizoheshin prezantime e debate të ndryshme edhe të karakterit politik. Ndër diskutimet e shumta duhet veçuar elaborati i akademikut serb, Vasa Çubriloviq, me titull “Shpërngulja e arnautëve”, i mbajtur më 7 mars 1937. Qysh në fillim të prezantimit, Çubriloviqi mohonte të drejtën e shqiptarëve mbi territorin ku ata jetonin. Ai theksoi se shqiptarët kishin zbritur nga malet dhe kishin okupuar tokat që serbët i kishin braktisur në shek. XVII kur kishin lëvizur drejt Veriut, duke krijuar kështu një trekëndësh ndarës midis Maqedonisë dhe Rashkës e Zetës, që i konsideronte toka serbe.⁴⁶ Duke risjellë në vëmendje arsyetimet e periudhës së Luftërave Ballkanike, ai vijonte ta konsideronte territorin e banuar nga shqiptarët si të një rëndësie strategjike, ku kalonin rrugët kryesore që çonin drejt Adriatikut e Egjeut, ndërsa shtjelloi edhe nevojën për shpërnguljen e shqiptarëve, e cila, sipas tij, duhej të ishte masive.

Elaborati i akademikut serb, Vasa Çubriloviq, në fakt, ishte një program që përllogariste të gjithë faktorët e mundshëm të përfshirë në procesin e shpërnguljes dhe, njëkohësisht, jepte edhe udhëzime se si të zbatohej ky program në praktikë. Në radhë të parë, ai përmendi qëndrimin e faktorit ndërkombëtar, duke theksuar se nuk priste ndonjë reagim të ashpër, përveç Shqipërisë.

“Nëse Gjermania mund t’i shpërngulë dhjetëra-mijëra hebrenj, nëse Rusia mund t’i shpërngulë miliona njerëz, atëherë nuk mund të pritej ndonjë luftë për të shpërngulur disa qindra-mijëra shqiptarë. Italia do të paraqiste pengesa, por ajo ishte e ngarkuar me Abisininë dhe Austrinë, kurse Francës e Anglisë u duhej sqaruar me gjakftohtësi se ishte edhe në interesin e tyre sigurimi i linjës Moravë-Vardar, që ishte dëshmuar edhe nga lufta e madhe, e kjo linjë do të ishte e sigurt si për ne ashtu edhe për ata, nëse ne mbizotërojmë plotësisht në aspektin etnik në rajonet rreth malit Sharr dhe në Kosovë”,⁴⁷ pohonte Çubriloviqi.

⁴⁵ Popović, “Srpski Kulturni Klub”, 130.

⁴⁶ ASHAK, F. Arkivi i Institutit Historik Ushtarak në Beograd (më tej: AIHU), D. Referati i parë i Vasa Çubriloviqit për shpërnguljen e shqiptarëve, i paraqitur më 7 mars 1937, 1.

⁴⁷ Bože Čović, *Izvori velikosrpske agresije, Rasprave / Dokumenti* (Zagreb: August Cesarec, Školska knj.,1991), 112.

Duke pohuar se nënshtrimi gradual i shqiptarëve përmes kolonizimit nuk ishte dëshmuar efikas, Çubriloviqi i shihte Turqinë dhe Shqipërinë si vende ku shqiptarët mund të shpërnguleshin masivisht. Sipas tij, Shqipëria me një popullsi të shpërndarë, me hapësira dhe lugina lumenjsh të parregulluara, do të ishte në gjendje të pranonte qindra mijëra të shpërngulur. Por, Turqia moderne, me një territor të madh në Azi të Vogël e Kurdistan, posedonte hapësira të papopulluara dhe mundësi reale për kolonizim. Ai mendonte se Turqia do të ishte në gjendje të pranonte deri në 200 000 të shpërngulur nga Jugosllavia, duke theksuar se këta duhej të ishin shqiptarë.⁴⁸ Në këtë periudhë mbi 85% e popullsisë së Kosovës dhe viseve të tjera të banuara me shqiptarë, merreshin me bujqësi dhe jetonin në fshat. Ky fakt e shtyu atë të propozonte që shpërngulja të kryhej së pari prej fshatrave e më pas të kalohej në qytete, sepse “*fshatrat*”, siç vinte ai në dukje në referatin e tij, “*janë kompakte prandaj paraqasin rrezik*”.⁴⁹

Çubriloviqi shihte dy mënyra për realizimin e planit të tij: 1) përmes krijimit të një psikoze të duhur, të shoqëruar me një propagandë fetare nga kleri mysliman dhe agjitorët e ndryshëm, që do të paguheshin apo kërcënoheshin, dhe 2) presionin e aparatit shtetëror mbi shqiptarët. Kjo nënkuptonte zbatimin e ashpër të ligjeve për t’ua bërë shqiptarëve jetën sa më të vështirë nëpërmjet gjobave, arrestimeve, dënimeve, prerjes së pyjeve, ndjekjeve etj. Në aspektin ekonomik sugjeronte mospranimin e tapive të shqiptarëve nga organet e kadastrës, që tatimet dhe borxhet publike të mblidheshin pamëshirshëm, përfshi edhe konfiskimin e kulturave bujqësore nga organet shtetërore. Të gjitha këto duhej të shoqëroheshin me armatosjen e elementit serb në Kosovë, për të provokuar konflikte masive me shqiptarët.⁵⁰ Njëkohësisht, ai propozonte edhe lehtësime administrative për ata që dëshironin të shpërnguleshin, sikurse dhënia e pasaportave të udhëtimit, transportimin deri te hekurudhat, apo edhe transportin hekurudhor falas. Në territoret e zbrazura do të vendoseshin kolonë nga viset e Hercegovinës, Likës, të Malit të Zi etj.⁵¹

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ Zamir Shtylla, “Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936-1941,” në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve* (Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992), 188.

⁵⁰ Ndreca, *87 vjet terror*, 81.

⁵¹ *ASHAK*, F. AIHU, D. Referati i parë i Vasa Çubriloviqit, 10-11.

Për realizimin e një projekti të tillë, Çubriloviqi mori parasysh edhe kostot financiare. Sipas tij, shpërngulja e 40 000 familjeve shqiptare, secila mesatarisht me pesë anëtarë, del se përafërsisht shpenzoheshin 15 000 dinarë për një familje, me maksimumin 600 000 dinarë. Shqiptarët e shpërngulur do të braktisnin jo vetëm shtëpitë, por edhe mjetet e punës. Kolonëve që do të hynin në këto shtëpi mund t'u jepej një ndihmë e lehtë përmes ushqimeve dhe bagëti.⁵²

Mendimet e qarqeve akademike serbe u pasuan me veprime politike. Në këtë periudhë po shkonin drejt përfundimit përpjekjet e palës jugosllave për të arritur një konventë shpërnguljeje me Turqinë, e cila do të lejonte dëbimin e detyruar, brenda disa vjetëve, të qindra mijëra shqiptarëve. Toka e sekuestruar shpallej tokë shtetërore dhe vihej në dispozicion për kolonizim. Tapitë dhe dokumentet që dëshmonin pronësinë as që u morën parasysh nga organet qeveritare.⁵³

Politikat e emigracionit në Turqi

Përgjatë historisë valë të popujve të ndryshëm u dyndën në territoret e Perandorisë Osmane. Këto dyndje ndikuan në hartimin e qëndrimit dhe të politikave kundrejt të shpërngulurve. Qeveritarët osmanë besonin se popullsia numerikisht e madhe ishte parakusht për zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen kundër armikut të jashtëm.⁵⁴ Në vazhden e këtij qëndrimi, por të shtyrë edhe nga arsyt humanitare, sulltanët osmanë pranuan vendosjen në tokat e Perandorisë të hebrenjve të cilët po largoheshin nga shtetet e krishtera të Europës, sidomos nga Spanja. Vlerësohet se deri në fund të shek. XV nga ky shtet lëvizën drejt Perandorisë Osmane rreth 250 000 hebrenj.⁵⁵ Pranimi i të huajve në Perandorinë Osmane vazhdoi edhe në vitet në vijim, ndërsa në vitin 1857 ishte miratuar dekreti që mundësonte vendosjen në tokat e Perandorisë Osmane të secilit person që i bindej dhe i nënshtrohej sulltanit dhe ligjeve

⁵² *Po aty*, 18.

⁵³ Marenglen Verli, *Kosova në fokusin e historisë*, vol. I (Tiranë: Botimpex, 2002), 292-293.

⁵⁴ Kemal H. Karpat, *Ottoman Population, 1830-1914: Demographic and Social Characteristics* (London: The University Winsconsin Press, 1985), 62.

⁵⁵ Stanford J. Shaw, *The Jews of the Ottoman Empire and the Turkish Republic* (London: MacMillan, 1991), 33-34.

të Perandorisë. Këtyre personave u garantoheshin liria fetare dhe të drejtat pronësore.⁵⁶

Luftërat që buruan nga Kriza Lindore e viteve 1875-1878 ndikuan në tkurrjen e Perandorisë Osmane, e si pasojë në drejtim të Anadollit u shpërngul një numër i madh i popullsisë së besimit islam, që u dëbuan nga vendbanimet e tyre. Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913 rezultuan me humbjen e pothuajse të gjitha territoreve të Perandorisë Osmane në Europë, një territor me më tepër se 60 000 milje katrorë. Duhet cekur se rajonet e humbura si, Maqedonia, Shqipëria dhe Trakia, që Perandoria Osmane i kishte mbajtur për 500 vjet, paraqisnin territore të pasura në aspektin ekonomik.⁵⁷ Si pasojë e luftërave, nga viti 1912 deri në vitin 1920, llogaritet se rreth 413 922 banorë të besimit islam nga Ballkani u vendosën në qytete të ndryshme të Turqisë së sotme.⁵⁸ Pa dyshim, në këto shifra përfshihen edhe shqiptarët, pasi regjistrimi i popullsisë në Perandorinë Osmane bëhej në baza fetare, e jo në ato etnike.

Rivendosja e popullsisë në vise të ndryshme të Perandorisë shkaktoi një problem të madh, jo vetëm të natyrës logjistike, por edhe të asaj financiare e kulturore. Si rrjedhojë, qarqet politike osmane do t'i integronin të sapoardhurit në strukturat ekzistuese të Perandorisë Osmane, pavarësisht ngarkesave financiare. Pavarësisht fatit të keq për refugjatët, që ishin detyruar t'i braktisnin trevat dhe pronat e tyre, ardhja e tyre në territorin osman ishte parë pozitive nga qeveria osmane në aspektin e faktorit demografik dhe të atij ekonomik. Popullsia osmane ishte zvogëluar dukshëm pas gjysmës së dytë të shek. XIX për shkak të luftërave, sëmundjeve e të fatkeqësive natyrore. Kjo u reflektua në mosshfrytëzimin e tokave bujqësore dhe në uljen e të ardhurave nga taksat. Vendosja e refugjatëve në toka të punueshme ofroi zgjidhje të menjëhershme, sepse ata paraqisnin një fuqi të nevojshme pune në sferën e bujqësisë. Po ashtu, refugjatët e vendosur u përdorën edhe si forcë mbrojtëse për hekurudhat dhe linjat telegrafike, kurse disa vjet më vonë u shndërruan edhe në taksapagues.⁵⁹ Vendosja e refugjatëve në rajone të

⁵⁶ Dilek Latif, "Refugee Policy of the Turkish Republic", *The Turkish Yearbook of International Relations*, vol. XXXIII (2002), 4.

⁵⁷ Eric J. Zürcher, *Turkey A Modern History* (London: IB Tauris, 2004), 108-109.

⁵⁸ McCarthy, *Vdekje dhe dëbim*, 168.

⁵⁹ Şevin Gülfer Sagniç, *Refugee reception in the Ottoman Empire and Turkish response to Syrian refugees*, 2020, 5 (shikuar më 05.04.2023)

caktuara lidhej me qëllimet ekonomike, sociale dhe ushtarake të Perandorisë, prandaj në vendosjen e tyre u zbatuan tri parime kryesore: 1) refugjatët myslimanë u vendosën në zonat periferike/kufitare; 2) refugjatët u vendosën në rajone të ngjashme me vendet e tyre të origjinës; dhe 3) u zbatua parandalimi i mbizotërimit të një grupi etnik në një rajon të caktuar.⁶⁰

Efektet anësore të humbjeve territoriale osmane ndikuan që turqit etnikë, për herë të parë në historinë e Perandorisë Osmane, të bëheshin popullsia më e madhe numerikisht e Perandorisë. Në të njëjtën kohë, ndryshimet politike që po zhvilloheshin në Europë dhe rrjedhimisht në Perandorinë Osmane u shoqëruan me forcimin e nacionalizmit turk,⁶¹ efektet e të cilit do të reflektohen në luftën për formimin e shtetit dhe të kombit turk. Në këtë mënyrë, periudha midis Dy Luftërave Botërore në historinë e shtetit turk shënon krahas të tjerave edhe dy qëllime madhore të politikës turke: të konsolidimit të shtetit dhe të homogjenizimit të shoqërisë turke, që nënkuptonte ndërtimin e një kombi unik, i cili do t'i asimilonte minoritetet joturke. Në perceptimin e themeluesve të tij, shteti i ri duhej të përfaqësonte një komb homogjen, banorët e të cilit do të ishin myslimanë besnikë, që flitnin dhe posedonin kulturën turke.⁶² Por, Anadulli nuk mund të homogjenizohej lehtësisht, pasi aty banonin kurdët, boshnjakët, shqiptarët, çerkezët dhe arabët, popuj që flisnin gjuhë të ndryshme nga turqishtja. Prandaj, për të arritur qëllimet e mësipërme pas një varg debatesh Parlamenti Turk miratoi më 1934 Ligjin për kolonizim, i njohur si ligji nr. 2510, i cili paraqiti dy standarde të qarta: a) lehtësimin e emigrimit dhe të integritimit të personave me “origjinë dhe kulturë turke”, dhe b) parandalimin dhe pengimin e hyrjes në Turqi të atyre që nuk i plotësonin kushtet e cekura më lart. Po i njëjti ligj rregullonte edhe procesin e asimilimit të qytetarëve që nuk kishin “origjinë apo kulturë turke”,⁶³ e që banonin në Turqi.

https://www.unhcr.org/people-forced-to-flee-book/wp-content/uploads/sites/137/2022/02/S%CC%A7evin-Sag%CC%86nic%CC%A7_Refugee-Reception-in-the-Ottoman-Empire-and-the-Turkish-Response-to-Syrian-Refugees-002.pdf

⁶⁰ *Po aty*, 112-113.

⁶¹ Zurcher, *Turkey A Modern History*, 117.

⁶² Ahmet İçduygu, Damla B. Aksel, “Turkish Migration Policies: A Critical Historical Retrospective,” *Perceptions*, vol. XVIII, no. 3 (2013), 171.

⁶³ *Po aty*.

Hartimi i këtij ligji karakterizohej nga mbizotërimi i ideologjisë nacionaliste të kohës. Tendencat e qarta për ndërtimin e një shoqërie homogjene dhe asimilimin e minoriteteve kombëtare u shprehën hapur nga politikanët turq të kohës. Gjatë diskutimeve parlamentare mbi Ligjin për kolonizim dolën në pah pikëpamjet nacionaliste e homogjeniste. Deputeti Sadri Maksud-i deklaronte:

“Turqizimi i gjuhës është një ndër mekanizmat më të mirë të sigurimit të ardhmërisë së racës turke dhe turkut për të jetuar si turk. Ky është qëllimi ynë”.

Kurse, Shukru Kaya, ministër i Brendshëm gjatë kohës së diskutimeve parlamentare, shprehu pikëpamjet e qeverisë në mënyrë të qartë:

“Ky ligj do të krijojë një shtet që flet me një gjuhë, që mendon njëjtë dhe që ka ndjenja të njëjta”.⁶⁴ *Sipas ligjit nr. 2510, konsideroheshin turq* “individët e racës turke apo të atyre që flasin gjuhën turke dhe që nuk dinë ndonjë gjuhë tjetër”.

Kështu nga kornizat zyrtare të kulturës turke përjashtoheshin komunitetet jomyslimane apo myslimanët që nuk flisnin gjuhën turke.⁶⁵ Si rrjedhojë, gjithë të tjerët me tipare të përafërta duhej të konvertoheshin në këtë kulturë. Parakusht për arritjen e një qëllimi të tillë ishte mënyra e vendosjes së refugjatëve. Neni 2 caktonte edhe zonat e kolonizimit, të cilat ndaheshin në tri kategori dhe vendosnin lidhje individuale me kulturën turke: rajone ku miratohej vendosja e popullsisë me kulturë turke; rajone të rezervuara për transferimin dhe vendosjen e popullsisë që konsiderohej e përshtatshme për t’u integruar në kulturën turke; rajone që do të shpopulloheshin dhe ku do të ndalohej vendosja dhe vendbanimi për shkaqe hapësinore, kulturore, sanitare, politike, ushtarake dhe çështjeve të sigurisë.⁶⁶

Ligji nr. 2510 i ofroi administratës turke një varg mekanizmesh për të asimiluar jo vetëm komunitetet emigrante, por edhe mijëra myslimanët të tjerë që nuk e kishin turqishten si gjuhë amtare, dhjetë vjet pas shpalljes së Republikës. Neni 1 i këtij ligji i jepte kompetencë Ministrisë

⁶⁴ Ulker Erol, “Assimilation, Security and Geographical Nationalism in Interwar Turkey: The Settlement Law of 1934”, *European Journal of Turkish Studies*, no. 7 (2008), Thematic issue (shikuar më 20.03.2023), <http://ejls.org/document2123.html>

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ “Kanun Nu: 2510” (*T. C. Resmi Gazete*, 1934), 4004 (“Ligji nr. 2510”, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Turqisë*, viti 1934, f. 4004).

së Brendshme për të menaxhuar shpërndarjen e popullsisë në territorin e vendit. Neni 11 përmbante masa të rëndësishme të cilat zbatoheshin, për të *“siguruar unitetin e gjuhës, kulturës dhe të gjakut”*. Në këtë mënyrë ndalohej themelimi i lagjeve apo i fshatrave që nuk e kishin turqishten si gjuhë amtare. Masat që mund t'i zbatonte Ministria e Brendshme konsistonin edhe në transferimin dhe shpërndarjen e popullsisë në zona të brendshme të vendit, madje edhe duke i privuar ata nga të drejtat shtetërore. Për më tepër, numri i refugjatëve të vendosur në qytete apo qyteza nuk mund të ishte më i lartë se 10% e popullsisë së përgjithshme të qytetit apo qytezës në fjalë.⁶⁷

Ligji për kolonizim i vitit 1934 kishte për qëllim sistemimin dhe integrimin në kombin turk të emigrantëve nga vendet ballkanike, prandaj tradita e mikpritjes së refugjatëve vazhdoi edhe gjatë kohës së Republikës së Turqisë. Banorë të shumtë nga Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Jugosllavia ikën për në Turqi të shtyrë nga arsytet politike, ekonomike, religjioze dhe etnike.⁶⁸ Ky emigrim që kishte rifilluar në vitin 1923 dhe që vazhdoi deri në fund të viteve 1930, kishte krijuar një popullsi emigrantësh prej 800 000 deri 850 000 banorësh. Numri më i madh ishte i myslimanëve që vinin nga Greqia, si rezultat i Marrëveshjes së vitit 1923 për shkëmbimin e popullsisë. Këta përbënin rreth 384 000 apo 61% nga 800 000 emigrantët. Gjatë këtyre viteve nga Bullgaria arritën në Turqi rreth 198 688 emigrantë, nga Rumania 117 095 dhe 115 210 banorë nga Jugosllavia gjatë viteve 1923-1939.⁶⁹ Në këtë pikë vihet në pah edhe dimensionin fetar që paraqiti emigracioni mbi shoqërinë turke. Emigrimi i dyfishtë, largimi i jomyslimanëve dhe ardhja e myslimanëve në Turqi, rezultoi me reduktimin e numrit të banorëve jomyslimanë në Turqi, nga 19% që ishte më 1914, në 3% më 1927, e në 1% viteve pasuese.⁷⁰ Ideja për një komb me gjuhë, kulturë dhe ndjenja të njëjta po realizohej me hapa të sigurt nga elita politike turke.

Në vazhden e këtij qëllimi diplomacia turke zhvillonte një propagandë aktive të popullsitë myslimane të vendeve ballkanike, për t'i bindur ata që të emigronin për në Turqi. Turqia kishte nevojë që ta rregullonte problemin demografik. Anadulli ishte shpopulluar në mënyrë drastike si rezultat i luftërave që ishin zhvilluar para themelimit të

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Latif, “Refugee Policy of the Turkish Republic”, 6.

⁶⁹ Ulker, “Assimilation of the Muslim Communities”.

⁷⁰ İçduygu & Aksel, “Turkish Migration Policies”, 172.

Republikës së Turqisë. Sipas të dhënave nga Justin McCarthy, popullsia e Anadollit Perëndimor ishte zvogëluar me 1 246 068 banorë gjatë viteve 1912-1922.⁷¹ Nacionalistët e shihnin ardhjen e të shpërngulurve si një mënyrë për rritjen e popullsisë, kurse myslimanët e Ballkanit i konsideronin si “vëllezër tanë të gjakut, të cilët kanë ngelur jashtë kufijve të atdheut të tyre të vërtetë të Turqisë”.⁷² Hamdullah Sufi, veprimtar nacionalist deklaronte në Parlamentin Turk se rajonet e zbrazura të Anadollit duhej të plotësoheshin me një popullsi prej dy milionë e gjysmë banorësh, ndërsa sjellja në Turqi e banorëve të komunitetit turk që jetonin në shtete të ndryshme të Ballkanit do ta zgjidhte problemin demografik aty.⁷³ Përveç arsyeve nacionale e ushtarake të përmendura më lart, Ankaraja zyrtare përpiqej që ta rriste numrin e popullsisë duke konsideruar se me rritjen e saj zgjerohej edhe autoriteti i saj ndërkombëtar.⁷⁴ Për të ndikuar në arritjen e qëllimeve demografike, qeveria turke në mënyrë sekrete kishte udhëzuar konsujt e saj në Jugosllavi të inkurajonin shpërnguljen drejt Turqisë të popullsisë myslimane. Konsulli turk në Shkup, i kishte deklaruar në besnikëri përkthyesit të konsullatës italiane në këtë qytet se:

“Qeveria ime ka nevojë absolute për njerëz dhe unë kam marr udhëzime sekrete për të inkurajuar eksodin e popullsisë myslimane”.⁷⁵

Arritja e marrëveshjes

Përpjekjet konkrete për arritjen e një marrëveshjeje në formë konvente midis Jugosllavisë dhe Turqisë kishin filluar qysh në fund të vitit 1935. Në mbledhjen e Komisionit ndërministror jugosllav, të mbajtur më 1 tetor të vitit 1935, të pranishmit u njoftuan për takimin që ministri i Jashtëm jugosllav kishte realizuar me homologun e tij turk, ku ishte arritur pajtimi formal për një marrëveshje turko-jugosllave, të

⁷¹ McCarthy, *Vdekje dhe dëbim*, 303.

⁷² Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 248.

⁷³ Ulker, “Assimilation of the Muslim Communities”.

⁷⁴ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 146.

⁷⁵ Hasan Bello, “Politika e Mbretërisë Shqiptare për parandalimin e shpërnguljes së kosovarëve drejt Turqisë dhe mosratifikimin e konventës jugosllavo-turke të vitit 1938”, në *Studime historike*, nr. 1-2 (2014): 189.

ngjashme me atë turko-rumune, në të cilën Turqia, në një periudhë prej 2-3 vjetësh, do të pranonte një popullsi prej 200 000 banorësh nga “Serbia Jugore”. Në maj të vitit 1936 i deleguari i Turqisë në Beograd ishte autorizuar që t’i fillonte bisedimet lidhur me arritjen e një marrëveshjeje turko-jugosllave për shpërnguljen e, sikurse theksonte një diplomat jugosllav, “popullsisë myslimane nga viset tona jugore”,⁷⁶ ndonëse të njëjtit, prapa fjalëve “popullsi turke apo myslimane”, nënkuptonin shqiptarët.

Tentativat për arritjen e një marrëveshjeje u gjallëruan gjatë janarit të vitit 1938, kur gjatë vizitës së Stojadinoviçit në Ankara ishte konfirmuar pajtimi për organizimin e shpërnguljes së “popullsisë turke” nga Jugosllavia në Turqi.⁷⁷ Në vazhden e këtij pajtimi, në shkurt të vitit 1938, Turqia doli me iniciativën për mbajtjen e një konference e cila do të diskutonte çështjen e shpërnguljes së “popullsisë turke”. Kjo nismë gjeti mirëkuptimin jugosllav, pasi kjo çështje gjendej në agjendën e saj politike qysh prej vitesh. Prandaj në qershor të vitit 1938 në Stamboll u mbajt një konferencë mes delegatëve jugosllavë dhe atyre turq, e cila u monitorua nga përfaqësuesit e Greqisë dhe të Rumanisë. Në këtë konferencë qeveria jugosllave përpqej që shpërnguljen nga Jugosllavia ta paraqiste jo vetëm si një çështje nacionale politike, por pikësëpari, si një prej çështjeve më të rëndësishme sociale – sepse me shpërnguljen e “myslimanëve” do të liheshin të lira sipërfaqe të mëdha të tokës pjellore, ku mund të vendosej një numër i madh i popullsisë malazeze, dalmatine, hercegovinase etj.⁷⁸ Diplomatët turq u shprehën se e shihnin me simpati emigrimin e myslimanëve të pjesës jugore të Jugosllavisë për në Turqi, por do të ishte e nevojshme një ndihmë financiare sepse ata do të vendoseshin në Anadoll e jo në Traki, prandaj edhe shpenzimet do të ishin më të larta. Si orientim u mor marrëveshja turko-rumune për shpërnguljen e myslimanëve nga Rumania. Pas një varg diskutimesh, konferenca përfundoi me një marrëveshje turko-jugosllave e cila u interpretua në një konventë, pikat kryesore të së cilës ishin: 1) nga Jugosllavia për në Turqi do të shpërnguleshin 40 000 familje myslimane të “Serbisë Jugore” nga territoret që i aneksoi Serbia e Mali i Zi pas luftërave të viteve 1912-1913; 2) shpërngulja do të realizohej brenda 6

⁷⁶ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 208.

⁷⁷ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë 1912-1939*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2013), 251.

⁷⁸ Hadri, “Pozita dhe gjendja e Kosovës”, 178-179.

vjetëve (1939-1944), me kushtin që mund të zgjatej edhe një vit përtej këtij afati; 3) Jugosllavia do t'i paguante Turqisë 500 lira turke për secilën familje të shpërngulur; prej të cilave 30% në valutë botërore, kurse 70% do të depozitoheshin në dinarë në llogari të qeverisë turke në bankën kombëtare. Me paratë e depozituara qeveria turke mund të blinte mallra në Jugosllavi; 4) pagesat paraprake do të bëheshin dy herë në vit, gjatë prillit dhe tetorit; 5) kjo konventë vlente vetëm për banorët fshatarë; për popullsinë qytetare shpërngulja ishte fakultative, vetëm nëse ata e dëshironin vetë shpërnguljen; 6) prona e paluajtshme e fshatarëve të shpërngulur kalonte në pronësi të shtetit. Përveç shumës që u duhej paguar autoriteteve turke për secilën familje të shpërngulur, qeveria jugosllave nuk do t'iu paguante asgjë të shpërngulurve për pasuritë e tyre, si fushat, livadhet, shtëpitë etj.; 7) të shpërngulurit mund të merrnin me vete pasuri të luajtshme dhe një pjesë të bagëtive; 8) transporti hekurudhor deri në Selanik mbulohej nga qeveria jugosllave, kurse nga Selaniku e më tej nga qeveria turke etj.⁷⁹

Konventa është hartuar në një mënyrë të tillë që të përdorej tek të gjithë myslimanët, pa përjashtuar edhe shqiptarët e këtij besimi. Në fakt, shpërngulja e shqiptarëve ishte thelbi i fshehtë i kësaj konvente. Në raportin e tyre rreth kësaj konvente zyrtarët jugosllavë shpreheshin të kënaqur se konventa mundësonte shpërnguljen e shqiptarëve krahas turqve, pasi theksi vihej qartë te “myslimanët që jetonin në trevat që më 1912-1913 iu bashkuan Serbisë dhe Malit të Zi”, që faktikisht ishin shqiptarë. Për më tepër, prona e paluajtshme e të shpërngulurve do të kalonte në pronësi të shtetit jugosllav.⁸⁰

Konventa parashihte orarin e pagesave dhe të shpërnguljeve si në vijim:

Tabela nr. 1: Plani i shpërnguljes⁸¹

Viti	Nr. i banorëve për t'u shpërngulur	Pagesa në lira turke
1939	4.000	2.000.000
1940	6.000	3.000.000
1941	7.000	3.500.000

⁷⁹ ASHAK, F. Arkivi Diplomatik i MPJ-së në Beograd, D. Ambasada jugosllave në Turqi, V. 1939, fl. 65-66.

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Po aty.

1942	7.000	3.500.000
1943	8.000	4.000.000
1944	8.000	4.000.000
Gjithsej	40.000	20.000.000

Konventa në fjalë përmbyllte angazhimet e Turqisë për të shpërngulur në territorin e saj të gjithë popullsinë turke që ndodhej në regjionet e Ballkanit. Gazeta “Balkan Herald” shkruante se rreth dy milionë turq nga Bullgaria, Rumania e Jugosllavia, apo nga ish-territore që gjatë Luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913 iu shkëputën Perandorisë Osmane, janë duke u dyndur për në Turqi. Turqia kishte përgatitur terrene në Anadoll dhe në vise të tjera në brendësi të saj për sistemimin e tyre. Por, ajo që vinte në pah gazeta ishte se popullsia që shpërngulej në Turqi duhej të ndërronte veshjen dhe mënyrën e jetesës, pasi ligjet e Turqisë nuk i lejonin këto zakone e shumë zakone të tjera.⁸² Nga kjo del se fjala ishte për shqiptarët, të cilët nën emërtimin “banorë myslimanë” do të shpërngulehin për në Turqi.

Përpjekjet e Shqipërisë për të penguar zbatimin e Konventës

Interesimi i shtetit shqiptar për bashkëkombësit e tij të mbetur jashtë kufijve politikë të Shqipërisë ka qenë i përhershëm, dhe është realizuar varësisht nga rrethanat politike të kohës apo nga fuqia politike e shtetit shqiptar. Një interesim i tillë filloi të jetë më i theksuar pas viteve 1930, kur shteti tashmë kishte filluar të konsolidohej. Synimi për ruajtjen e Kosovës shqiptare, në pritje të koniunkturave të favorshme ndërkombëtare që do të lejonin korigjimin e padrejtësive të kryera në forumet ndërkombëtare të njohura të viteve para e pas Luftës së Parë Botërore, përcaktuan edhe veprimtarinë politike e diplomatike të shtetit shqiptar, në veçanti gjatë periudhës 1925-1939. Për të penguar shpërnguljen e shqiptarëve u shquan përfaqësitë diplomatike shqiptare, veçanërisht në Shkup, Manastir, Beograd, Selanik dhe Stamboll.⁸³ Në nëntor të vitit 1932 diplomati shqiptar, Nezir Leskoviku, u autorizua të takohej me ministrin e Jashtëm turk Ruzhdu Aras për t'i kërkuar atij që

⁸² Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (më tej: *AIH*), A-105, V. 1938, D. Legata britanike, fl. 440.

⁸³ Marenglen Verli, “Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20-30 të shek. XX,” *Kosova*, nr. 31-32 (2009), 41-42.

konsullatat turke të ndalonin dhënien e vizave për kosovarët, kërkesë që u përmbush dhe u respektua vetëm për një kohë të shkurtër. Në vitin 1934 edhe Mbreti Zog ndërhyri personalisht pranë Mustafa Qemal Atatürkut për të penguar shpërnguljen, kurse si kundërmasë ai themeloi më 1935 Drejtorinë e Reformës Agrare, e cila kishte për qëllim sistemimin e emigrantëve kosovarë në brendësi të territorit shqiptar.⁸⁴

Argumentet për angazhimin e diplomacisë shqiptare në parandalimin e shpërnguljeve dhe ndihmës për të shpërngulurit dëshmohen edhe nga burimet jugosllave. Konsullata jugosllave në Stamboll njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, në korrik të vitit 1936, se konsullata shqiptare në Stamboll kishte filluar një fushatë të gjerë për të penguar shpërnguljen. Shqiptarëve, të cilët ishin shpërngulur në Perandorinë Osmane/Turqi para e pas Luftës së Parë Botërore, që dëshironin të ktheheshin në trevat e tyre e që rikthimi i tyre refuzohej nga konsullata jugosllave në Stamboll, konsullata shqiptare në të njëjtin qytet u ofronte atyre lehtësira që të ktheheshin në Shqipëri, duke i pajisur me viza udhëtimi pa pagesë ata qytetarë me kombësi shqiptare që kishin pasaporta turke e që llogariteshin nënshtetas turq.⁸⁵

Në vazhden e interesimit për bashkëkombësit e saj, në janar të vitit 1937, qeveria shqiptare krijoi një komision të posaçëm nën kryesinë e ministrit të Jashtëm Ekrem Libohova, me anëtarë Rauf Ficon i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë në Beograd, Eqrem Vlorën sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme dhe Hamdi Karazin, zëvendës drejtor në MPJ për punët e Lidhjes së Kombeve. Komisioni, pasi konstatoi politikën shkombëtarizuese jugosllave në Kosovë dhe synimin për shpërnguljen e tyre në Turqi, e gjykoi të arsyeshme të vazhdonte përpjekjet për mbrojtjen e elementit shqiptar në Jugosllavi, duke kundërshtuar emigrimin e tij kudo qoftë, duke organizuar elementët nacionalistë të Kosovës. Komisioni sugjeroi që të kërkohej ndihma e qeverisë italiane për të penguar shpërnguljen dhe të negociohej me qeverinë jugosllave për krijimin e një zone përgjatë kufirit, ku popullsia shqiptare do t'i gëzonte të drejtat minoritare etj.⁸⁶ Lidhur me ndihmën e qeverisë italiane, ministri i Jashtëm italian, konti Ciano, premtoi të bisedonte me homologët e tij jugosllavë e turq. Derisa diplomacia turke

⁸⁴ Bello, "Politika e Mbretërisë Shqiptare", 192-194.

⁸⁵ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 217-218.

⁸⁶ Bello, "Politika e Mbretërisë Shqiptare", 200.

deklaronte se nuk do të pranonte “myslimanë të racave tjera”, pra edhe asnjë shqiptar nga Kosova, Stojadinoviçi dhe zyrtarë të tjerë jugosllavë demarsheve të Tiranës iu përgjigjën me refrenin e vjetër se “autoritetet jugosllave nuk shtrëngonin as edhe një shqiptar për të emigruar në Turqi”, ndërkohë që vazhdonin bisedimet me qeverinë turke për largimin e shqiptarëve.⁸⁷

Përpjekjet e qeverisë shqiptare për të penguar shpërnguljen morën një karakter më intensiv me të marrë informacionet mbi arritjen e marrëveshjes turko-jugosllave, ngaqë zbatimi i saj do të shoqërohej me largimin e një numri të madh shqiptarësh nga Kosova. Edhe pse kryeministri jugosllav kishte deklaruar në Shkup se marrëveshja kishte të bënte vetëm me shtetasit jugosllavë me origjinë turke, të cilët dëshironin të shpërnguleheshin, qeveria shqiptare brengosej se në këtë shpërngulje mund të përfshiheshin shqiptarët e besimit mysliman.⁸⁸ Tirana zyrtare nuk ishte qetësuar as kur ambasadori turk në Shqipëri i kishte dhënë garanci ministrit të Jashtëm shqiptar se në cilësinë e emigrantit do të pranoheshin vetëm personat me origjinë turke. Sipas një diplomati britanik të akredituar në Shqipëri, këto garanci kishin shumë pak rëndësi për autoritetet shqiptare tek të cilat mbizotëronte pikëpamja se të gjithë myslimanët e Kosovës ishin shqiptarë, ndërsa numri i banorëve sllavë apo turq aty ishte shumë i vogël.⁸⁹

Për të penguar procesin e shpërnguljes së popullatës shqiptare nga Kosova, qeveria shqiptare nisi aktivitetet diplomatike, të cilat i konsideronte si të vetmen rrugë të mundshme që mund të jepte rezultat. Në këtë mënyrë ministri i Jashtëm Libohova, përveçse kishte protestuar në Beograd e Ankara kundër realizimit të marrëveshjes për shpërngulje, kërkoi nga ministri britanik në Durrës që të ndikonte te qeveria britanike në mënyrë që ajo të ndërhynte për të ndaluar shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova.⁹⁰ Në përgjigje të kësaj kërkesë, ministri britanik në Durrës e paralajmëroi Libohovën që qeveria shqiptare nuk duhej të shpresonte në mbështetjen britanike.⁹¹ Një deklaram i tillë ishte i sinqertë dhe në përputhje me rrethanat e kohës. Në kohën kur Britania po ballafaqohej

⁸⁷ Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë 1912-1939*, 862-863.

⁸⁸ Živko Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji (1931-1938)* (Zagreb: Globus, 1986), 651.

⁸⁹ *AIH*, F: A-105, Dosja: Legata britanike, Viti: 1938, 436.

⁹⁰ *Po aty*, 438.

⁹¹ *Po aty*, 439.

me përpjekjet gjermane e italiane për të mbizotëruar në Ballkan, nuk do ta shihte të udhës të angazhohej në një çështje për të cilën nuk kishte aspak interes, sidomos kur asaj i nevojiteshin Jugosllavia e Turqia për të formuar një barrierë kundërgjermane.

Pavarësisht se konventa ishte arritur në korrik të vitit 1938, ajo nuk ishte ratifikuar ende nga parlamentet e të dyja vendeve. Vështirësitë kryesore qëndronin te numri i madh i popullsisë që duhej shpërngulur. Qysh në shkurt të vitit 1937, konsulli i Shqipërisë në Shkup kishte parashikuar se Turqia gjatë tre vjetëve të ardhshëm nuk do të ishte në gjendje të pranonte 100 000 “myslimanë” që Jugosllavia planifikonte t’i shpërngulte.⁹² Mosratifikimi i Konventës i dha hapësirë qeverisë shqiptare që të vazhdonte me përpjekjet e saj për ta parandaluar ratifikimin dhe zbatimin e saj. Ajo veprroi në dy drejtime: gjatë gjysmës së dytë të vitit 1938 udhëzoi stafin e vet diplomatik në Jugosllavi për politikën që duhej të ndiqte për të ndihmuar popullatën shqiptare atje, dhe njëkohësisht në anën tjetër, autorizoi një delegacion të kryesuar nga Ferhat Draga, që në fillim të gushtit të vitit 1938 të udhëtonte në Stamboll e Ankara për të ndikuar te qeveria e Turqisë për të mos e miratuar konventën për shpërnguljen e shqiptarëve nga viset e tyre në Jugosllavi, apo së paku për të ndikuar që në këtë konventë të mos përfshiheshin shqiptarët e viseve në fjalë.⁹³

Në plan të parë, Mbreti Zog kishte vënë kontrollin mbi Komitetin e Kosovës, duke e riorganizuar atë më 1936 dhe duke krijuar celula (grupe veprimi) rreth kufirit me Jugosllavinë. Nëpërmjet këtyre celulave zhvilloheshin të gjitha veprimet për organizimin e shqiptarëve në Jugosllavi, si dhe mbajtja e lidhjeve të fuqishme me to. Qendra kryesore e celulave ilegale të kosovarëve ishte në Gjakovë.⁹⁴ Në këtë mënyrë, përmes instruksioneve që vinin nga Shqipëria, paria e popullsisë shqiptare në Kosovë me në krye bejlerët, hoxhallarët e dervishët po punonin në mënyra të ndryshme për ta bindur popullsinë shqiptare që të mos largohej nga trojet e veta.⁹⁵ Paria në fjalë përpiquej të ndërjegjëonte

⁹² Mile Bjelajac, “Migrations of Ethnic Albanians in Kosovo 1938-1950”, *Balkanica*, no. XXXVII/2007 (2007): 226.

⁹³ Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova - historia e një aspirate (Studime historike, kumtesa, dokumente dhe ilustrime)* (Tiranë: Botimpex, 2007), 294.

⁹⁴ Halim Purellku, “Veprimtaria e Komitetit të Kosovës në Mbretërinë Shqiptare në vitet 1934-1939”, në *Studime historike*, nr. 3-4 (2009): 172.

⁹⁵ ASHAK, F. AIHU, D. Elaborat 20/Popisnik 17, V. 1920-1941, 54.

shqiptarët për synimet e politikës jugosllave, për t'iu shmangur kurtheve të Beogradit që përpiquej t'i dëbonte në Turqi, si dhe për t'i inkurajuar se Shqipëria po bënte të gjitha përpjekjet në favor të tyre.⁹⁶

Ndërkaq diplomacia shqiptare ndërmori një aktivitet të dendur në Turqi në përpjekje për ta parandaluar shpërnguljen. Burimet diplomatike jugosllave supozonin se Ferhat Draga nga ana e tij mund t'u ketë parashtruar deputetëve turq një memorandum, ku kishte paraqitur pikëpamjet e veta për këtë çështje.⁹⁷ Misioni i Ferhat Dragës u pasua nga vizita që diplomati shqiptar, Mehmet Konica, i bëri Athinës dhe Stambollit nga mesi i shtatorit, në përpjekje për ta afruar Shqipërinë me këto dy vende me qëllim të aderimit në iniciativat ballkanike dhe, njëkohësisht, për të ndikuar te qeveria turke për të penguar realizimin e shpërnguljes së shqiptarëve.⁹⁸ Përpjekjet e diplomacisë shqiptare rezultuan të suksesshme. Tahir Shtylla, nga legata shqiptare në Beograd, që më 10 korrik 1938 e kishte njoftuar qeverinë shqiptare mbi premtimet që Ataturku i kishte dhënë Ferhat Dragës për të mos e lejuar shpërnguljen e shqiptarëve drejt Turqisë.⁹⁹ Zotimi i Ataturkut vërtetohet nga një raport që konsulli jugosllav i dërgonte Beogradit, më 4 maj 1939, ku e njoftonte qeverinë jugosllave se:

“Qeveria turke ka vullnetin që të nënshkruajë konventën, por në situatën aktuale ajo është e detyruar të ndërpresë çdo projekt që nuk ka të bëjë me mbrojtjen kombëtare. Prandaj, pasi Turqia nuk është gjendje ta zbatojë konventën, nënshkrimi i saj duhet të shtyhet. Mund të bisedohet më tej vetëm nëse Jugosllavia është e vullnetit që ta shtojë kontributin e saj në financimin e shpërnguljes”. *Por, njëkohësisht, në të njëjtin raport konsulli jugosllav deklaronte se: “...dua të shtoj se Turqia nuk i ka ndërprerë projektet e shumta të cilat nuk hyjnë në sferën e mbrojtjes kombëtare”.*¹⁰⁰

Pavarësisht tentativave për të zbatuar marrëveshjen, fillimi i Luftës së Dytë Botërore vulosi përfundimisht dështimin e realizimit të

⁹⁶ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, (Tiranë: Kristalina-KH, 2020), 614-615.

⁹⁷ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë*, 282-283.

⁹⁸ ASHAK, F. P. Millovnoviq, D. Konsullata në Turqi, V. 1938, 1.

⁹⁹ Marenglen Verli, *Nga Kosova për Kosovën*, vol. I (Tiranë: Botimpex, 2006), 220.

¹⁰⁰ ASHAK, F. Arkivi Diplomatik i MPJ-së në Beograd, D. Ambasada jugosllave në Turqi, V. 1939, 78.

Konventës turko-jugosllave të vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondi: Komiteti i Kosovës.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK)

Fondi: Arkivi Diplomatik i MPJ-së në Beograd.

Arkivi i Institutit Historik Ushtarak në Beograd (AIHU)

Fondi: P. Millovnoviç, 1938.

Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (AIH)

Botime dokumentare:

Lita, Qerim. *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë 1922-1941 (Përmbledhje dokumentesh)*. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019.

Čović, Bože. *Izvori velikosrpske agresije, Rasprave / Dokumenti*. Zagreb: August Cesarec, Školska knj., 1991.

Literaturë historiografike:

Avramovski, Živko. *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji (1931-1938)*. Zagreb: Globus, 1986.

Bajrami, Hakif. *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb (1844-1995)*. Prishtinë: QIK, 1995.

Bajrami, Hakif. “Ilija Garashanin dhe politika e tij shtetërore 1844-1874”. *Vjetari-Godišnjak*, nr. XXIV (1988), 129. Milo, Paskal. *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*. Tiranë: Shtëpia Botuese “Enciklopedike”, 1992.

Bajrami, Hakif. “Konventa jugosllave-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve”. Në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Hakif Bajrami (red.). Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992.

Bajrami, Hakif. *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*. Prishtinë: Instituti i Historisë, 1981.

Bello, Hasan. “Politika e Mbretërisë Shqiptare për parandalimin e shpërnguljes së kosovarëve drejt Turqisë dhe mosratifikimin e konventës jugosllavo-turke të vitit 1938”. Në *Studime historike*, nr. 1-2, 2014.

Bjelajac, Mile. “Migrations of Ethnic Albanians in Kosovo 1938-1950”. *Balkanica*, no. XXXVII/2007 (2007).

Castellan, George. *Histori e Ballkanit*. Tiranë: Çabej, 1997.

- Čulinović, Ferdo. *Jugoslavija između dva rata*, Knjiga II. Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umijetnosti, 1961.
- Enciklopedija Jugoslavije*. Zagreb: Izd. i Naklada Leksikografskog Zavoda, 1958.
- E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Kristaq Prifti (red.). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1990.
- Gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi, Promemorie e paraqitur në Lidhjen e Kombeve (1930) nga dom Gj. Bisaku, dom Sh. Kurti, dom L. Gashi*. Redaktorë Briseida Mema, Marenglen Verli. Tiranë: Koha, 1995.
- Hadri, Ali. "Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1919-1941)". Në *E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Kristaq Prifti (red.). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1990.
- Hadri, Ali. "Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)". *Gjurmime Albanologjike*, nr. 2, 1968.
- Hall, Richard C.. *The Balkan Wars 1912-1913: Prelude to the First World War*. London, New York: Routledge, 2000.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2007.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Kristalina-KH, 2020.
- Hrabak, Bogumil. "Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države s arbanaškom većinom stanovništva u jesen 1918. godine i držanje arbanasa prema uspostavljenoj vlasti". *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1, 1969.
- Içduygu, Ahmet & Damla B. Aksel, "Turkish Migration Policies: A Critical Historical Retrospective". *Perceptions*, vol. XVIII, no. 3, 2013.
- Islami, Hivzi. *Spastrimet etnike – politika gjenocidiale serbe ndaj shqiptarëve (Shqyrtime, komente, elaborate, dokumente)*. Pejë: Dukagjini, 2003.
- Jelavich, Barbara. *Historia e Ballkanit, Shekulli tetëmbëdhjetë-nëntëmbëdhjetë*. Tiranë: Përpjekja, 1999.
- "Kanun Nu: 2510" (*T. C. Resmi Gazete*, 1934), 4004 ("Ligji nr. 2510", *Gazeta Zyrtare e Republikës së Turqisë*, viti 1934, f. 4004).
- Karpat, Kemal H. *Ottoman Population, 1830-1914: Demographic and Social Characteristics*. London: The University Winsconsin Press, 1985.
- Latif, Dilek. "Refugee Policy of the Turkish Republic". *The Turkish Yearbook of International Relations*. Vol. XXXIII, 2002.
- McCarthy, Justin. *Vdekje dhe dëbim – Spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922*. Tiranë: Alsar, 2017.
- Milo, Paskal. *Politika e jashtme e Shqipërisë 1912-1939*, vëll. I. Tiranë: Toena, 2013.

- Ndreca, Mikel. *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*. Prishtinë: Rentabil-Kosova, 2001.
- Obradović, Milan. *Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005.
- Popović, Nebojša A. "Srpski kulturni klub (1937-1941)," *Istorija 20. Veka*, nr. 1-2, 1989.
- Purelku, Halim. "Veprimtaria e Komitetit të Kosovës në Mbretërinë Shqiptare në vitet 1934-1939". Në *Studime historike*, nr. 3-4, 2009.
- Rahimi, Shukri. *Vilajeti i Kosovës*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste të Kosovës, 1969.
- Rexha, Sabri. *Raportet shqiptaro-serbe në Kosovë*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011.
- Rushiti, Liman. *Kujtime për Lëvizjen Kaçake*. Prishtinë: 2003.
- Stavrianos, L.S. *Balkans since 1453*. London: Hurst & Company, 2000.
- Споменица Лјубомира Давидовића. Београд: 1940 (*Spomenica Ljubomira Davidovića*, Beograd: 1940).
- "Srpski kulturni klub izabrao je sinoñ svoju upravu", *Politika*, Београд, 5.2.1937, 9. ("Srpski kulturni klub izabrao je sinoć svoju upravu", *Politika*, Beograd, 5.2.1937).
- Shaw, Stanford J. *The Jews of the Ottoman Empire and the Turkish Republic*. London: MacMillan, 1991.
- Shtylla, Zamir. "Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936-1941". Në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*. Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992.
- Uka, Sabit. "Planet antishqiptare të shteteve fqinje në shekullin XIX". *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, Sadri Feti (red.), et. al. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1996.
- Verli, Marenglen. "Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20-30 të shek. XX". *Kosova*, nr. 31-32, 2009.
- Verli, Marenglen. *Kosova në fokusin e historisë*, vol. I. Tiranë: Botimpex, 2002.
- Verli, Marenglen. *Nga Kosova për Kosovën*, vol. I. Tiranë: Botimpex, 2006.
- Verli, Marenglen. *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1992.
- Verli, Marenglen. *Shqipëria dhe Kosova - historia e një aspirate (Studime historike, kumtesa, dokumente dhe ilustrime)*. Tiranë: Botimpex, 2007.
- Zurcher, Eric J. *Turkey A Modern History*. London: IB Tauris, 2004.
- Војводић, Михаило. *Србија и Албанско питање крајем XIX Века*, vol. Књига 15. Београд: Српска Академија Наука и Уметности, Одељење Историјских Наука, 1990). (Mihailo Vojvodić, *Srbija i*

- Albansko Nimane krajem XIX Veka*, vol. Knjiga 15. Beograd: Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Odeležene Istorijских Nauka).
- Димић, Љубодраг. “Слободан Јовановић и Српски културни клуб (1937-1941)”. Në *Слободан Јовановић, поводом 150 година од рођења, ред. Марко Анђелковић*. Београд: Српска Академија Наука и Уметности, 2020 (Ljubodrag Dimić, "Slobodan Jovanović i Srpski kulturni klub (1937-1941)". Në *Slobodan Jovanović Novodom 150 godina od pozhena*, Marko Anzheliković (red.). Beograd: Srpska Aademija Nauka i Umetnosti, 2020).
- Крстић, Ђорђо. *Колонизација Јужне Србије*. Сарајево:1928 (Gjorgjo Krstić, *Kolonizacija Juzhne Srbije*, Sarajevo: 1928).

Site:

Ethnic cleasning (shikuar më 05.07.2023).

<https://www.un.org/en/genocideprevention/ethnic-cleansing.shtml>.

Дедијер, Јевто. “Стара Србија географска и етнографска слика (1912.)”. Београд: 2000 (Jevto Dedijer, “Stara Srbija geografska i etnografska slika (1912)”. Beograd, 2000) (shikuar më 10.04.2023)

<https://dokumen.tips/download/link/dr-jevto-dedijer-stara-srbija-geografska-i-etnografska-slika.html>.

Sagniç, Şevin Gülfer. *Refugee reception in the Ottoman Empire and Turkish response to Syrian refugees*, 2020, 5 (shikuar më 05.04.2023)

https://www.unhcr.org/people-forced-to-flee-book/wp-content/uploads/sites/137/2022/02/S%CC%A7evin-Sag%CC%86nic%CC%A7_Refugee-Reception-in-the-Ottoman-Empire-and-the-Turkish-Response-to-Syrian-Refugees-002.pdf.

ARMEND MEHMETI

Institute of History “Ali Hadri”, Prishtina
armend.mehmeti@gmail.com

S u m m a r y

BETWEEN EXPULSION AND ASSIMILATION
ATTEMPTS TO DISPLACE ALBANIANS FROM KOSOVO
THE TURKISH-YUGOSLAV CONVENTION OF 1938

The rise and strengthening of the Serbian state in the first half of the nineteenth century was accompanied by projects for a pure ethnic Serbian state.

This was followed by its expansion into its neighbors. These projects took on a greater dimension during the first half of the twentieth century. They were oriented toward the south or territories inhabited by Albanians that provided access to the Aegean and the Adriatic. However, it could not expand towards the north and west because it bordered Austria-Hungary or in the east, Bulgaria. The occupation of Albanian lands by Serbia during the Balkan Wars was accompanied by efforts to expel Albanians and denationalize these territories. Such a policy was also followed during the interwar period. The Agrarian Reform and Colonization programs aimed at changing Kosovo's ethnic structure had not produced the expected results, so mass Albanian deportations to Turkey was planned. This project, drafted during the 30s, was finalized in 1938 when the Turkish-Yugoslav agreement was signed for the deportation of 40,000 Albanian families (200.000 persons) from Kosovo and other territories inhabited by the Albanian population in the former Yugoslavia to Turkey. The agreement was matched with the demographic needs of the Turkish state, since the last years of the Ottoman Empire were accompanied by numerous war developments, resulting in drastic population reduction. Turkey in this period welcomed Muslims from the Balkans (Romania, Bulgaria, Greece and Yugoslavia). These Muslims were gradually assimilated into the Turkish nation through administrative laws and regulations. The expulsion of about 40,000 Albanian families from their lands raised serious concern in Albania. Albanian diplomacy used all mechanisms and traditional Turkish-Albanian ties to prevent the agreement's implementation. The agreement was not approved by the Turkish parliament and was not implemented. Meanwhile, the Second World War broke out, creating other political circumstances and the convention was never implemented.

